



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:045537
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05619859

PPP.nr.607/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditorit B.M nga P, me numër personal të identifikimit ..., kundër debitorit Telekom i Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, me numër unik identifikues ... dhe numër të biznesit ..., lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, vlera 90,000.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga ana e palës debitore, kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.060/20, të datës 05.03.2020, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat K.M në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25.04.2024, mori dhe të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhëri Përmbartimor P.nr.060/20, i datës 05.03.2020, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat K.M në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, MBETET NË FUQI.

II. Në rast se pala debitore parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 90,000.00 €.

III. Në rast se pala debitore dështon të paguajë shumën e lartëcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat K.M në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit B.M nga P, ka lëshuar Urdhërin Përmbartimor P.nr.060/20, të dt.05.03.2020, me të cilin është lejuar përmbartimi në bazë të dokumenteve të besueshme: faturës nr.2/2020, të datës 30.01.2020; faturës nr.01/2020, të datës 02.01.2020; faturës nr.12/2019, të datës 26.11.2019; faturës nr.11/2019, të datës 29.10.2019; faturës nr.10/2019, të datës 26.09.2019; faturës nr.9/2019, të datës 28.08.2019; fatura nr.8/2019, e dt.29.07.2019; fatura nr.7/2019, e dt.27.06.2019; fatura nr.6/2019, e dt.28.05.2019; fatura nr.5/2019, e dt.30.04.2019. Mbi bazën e këtyre dokumenteve është caktuar

përmbartimi dhe është detyruar debitori që t'ia paguajë kreditorit borxhin në shumë prej 90,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të afatit për pagesë të faturave e gjer në pagesën definitive të borxhit kryesor, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, duke u ekzekutuar përmes: 1) Ndalimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës në llogari të veçantë; 2) Përmbartimin mbi letrat me vlerë dhe pjesët në shoqëritë tregtare, përmes regjistrimit të aksioneve në pronësi të debitorit dhe të letrave me vlerë në shoqëritë tregtare, si dhe kapitalin themelues ose kapitalin shtesë në një kompani aksionare apo çfarëdo forme tjetër ligjore; 3) Regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që nga shitja e realizuar të përmbushet dhe shlyhet borxhi kryesor, kamata ligjore si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër Urdhërit Përmbartimor të lartëcekur, brenda afatit të përcaktuar ligjor prapësim ka paraqitur pala debitore. Në prapësimin e parashtruar, ndër tjera pretendohet se kërkesa e palës kreditore është në tërësi e pa bazuar, ndërsa Urdhëri për Përmbartim nuk mund të ekzekutohet, përkatësisht dokumentet e bashkangjitura – faturat nuk e kanë cilësinë e dokumenteve të besueshme, sikurse është paraparë me dispozitën nga neni 29 të LPP-së. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar Gjykatës që në kuptim të dispozitës nga neni 73 par.1 të LPP-së të caktojë seancë publike, duke konsideruar se një veprim i tillë është i domosdoshëm për të vërtetuar plotësisht validitetin e prapësimin. Tutje pretendohet se debitori i përmbartimit e konteston në tërësi Urdhërin Përmbartimor edhe mbi bazën e pretendimit se për pagesën e qirasë është kompetente të vendosë Gjykata në procedurë kontestimore e kurrsesi përmbartuesi privat në procedurë përmbartimore, sikurse ka vepruar në rastin konkret, duke aluduar në faktin se i njejt ka shkëlur kompetencat ligjore me rastin e lejimit dhe caktimit të përmbartimit në bazë të Kontratës së Qirasë nr.01-5023/10 të dt.31.12.2019 dhe Marrëveshjes për Pagesën e Borxhit të dt.13.02.2020, për faktin se kompetenca ekskluzive lidhur me një çështje të tillë i takon Gjykatës. Më tej ka theksuar se ekziston bazë e mjaftueshme që Gjykata të shfuqizojë Urdhërin Përmbartimor konform dispozitës së nenit 43.4 të LPP-së, respektivisht prapësimi i debitorit është i bazuar dhe në përputhje me dispozitën nga neni 71 të LPP-së, Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa Urdhëri Përmbartimor P.nr.060/20, i dt.05.03.2020 të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësimin e ushtruar nga ana e debitorit ka paraqitur pala kreditore. Në përgjigje ndër tjera theksohet se pretendimet e palës debitore nuk gjejnë mbështetje në ligjin për procedurën përmbartimore dhe të njejtat nuk kanë asnjë bazë ligjore dhe si të tilla janë pa relevancë. Tutje theksohet se Urdhëri Përmbartimor është caktuar në bazë të dokumentit të besueshëm, i cili përmban të gjitha elementet e nevojshme të parapara në ligjin për procedurën përmbartimore dhe si i tillë nuk përbën ndonjë të metë juridike. Një pretendim të tillë e ka mbështetur në dispozitën nga neni 29 të LPP-së, të cilën e ka cituar në referat të përgjigjes në prapësim. Më tej pretendon se në rastin konkret, kreditori ka bashkangjitur një faturë origjinale dhe nëntë fatura të vërtetuara nga ana e noterit, ndërsa të njejtat janë të pranuar (protokolluara) nga ana e debitorit. Tutje e ka kundërshtuar edhe propozimin e debitorit të paraqitur në prapësim lidhur me caktimin e seancës gjyqësore për të vërtetuar validitetin e prapësimin, mbi bazën e pretendimit se dokumentet e prezantuara janë më se të mjaftueshme për të argumentuar faktin se urdhëri përmbartimor duhet të mbetet në fuqi. Për të dëshmuar besueshmërinë e faturave, pretendon se në shkresat e lëndës është bashkangjitur edhe Marrëveshja e Qirasë nr.01-5023/10, e dt.04.10.2010, ndërsa meqenëse debitori ka rënë në vonesë për pagesën e qirave mujore sipas marrëveshjes së lartëcekur, respektivisht faturave të lëshuara, kreditori i ka mundësuar debitorit që pagesat e vonuara t'ia paguajë përmes Marrëveshjes për pagesën

e borxhit të dt.13.02.2020, të cilën debitori ka dështuar ta respektojë. Po ashtu, e ka kundërshtuar edhe pretendimin e debitorit se përmbaruesi privat nuk është kompetent për vendosjen e kësaj çështje, si dhe lidhur me faktin se propozimi për përmbarim është lejuar në bazë të marrëveshjeve të lartëpërmendura, duke sqaruar faktin se në rastin konkret propozimi për përmbarim është inicuar në bazë të dokumenteve të besueshme. Mbi bazën e pretendimit se prapësimi i debitorit nuk gjen mbështetje në asnjë provë, sikurse e parasheh dispozita nga neni 69 par.6 e LPP-së, si dhe mungojnë shkaqet e prapësimit të parapara me nenin 71 të të njejtit ligj, ka propozuar që të refuzohet si i pa themeltë prapësimi, ndërsa të mbetet në fuqi Urdhëri Përmbarimor P.nr.060/20, i dt.05.03.2020.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe vëmendje të pretendimeve të palës debitore të parashtruara në prapësim, pretendimeve të palës kreditore të parashtruara në përgjigje në prapësim, si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi është i pa bazuar, mbi bazën e arsyeve si në vijim:

Dispozita nga 21 e Ligjit për Procedurën Përmbarimore (tani e tutje LPP), e cila i referohet bazës juridike për caktimin e përmbarimit, parasheh që: "*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*". Në anën tjetër, dispozita e nenit 29 par.1 e LPP-së përcakton llojet e dokumenteve të besueshme, mbi bazën e të cilave mund të caktohet përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla, duke përcaktuar se: "*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. fatura*". Paragrafi 3 i të njejtës dispozitë përcakton: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, rrjedhimisht prezenca e këtyre elementeve e determinon cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarim është paraqitur duke u mbështetur në dokumentet si në vijim: fatura nr.2/2020, e dt.30.10.2020, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.01/2020, e dt.02.01.2020, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.12/2019, e dt.26.11.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.11/2019, e dt.29.10.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.10.2019, e dt.26.09.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.9/2019, e dt.28.08.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.8/2019, e dt.29.07.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.7/2019, e dt.27.06.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.6/2019, e dt.28.05.2019, në vlerë prej 9,186.44 €; fatura nr.5/2019, e dt.30.04.2019, në vlerë prej 9,186.44 €.

Nga vështrimi i këtyre dokumenteve - faturave, Gjykata vlerëson se të njejtat përmbajnë të dhëna për kreditorin dhe debitorin, si dhe është përcaktuar objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Për më tepër, faturat në fjalë rezultojnë të jenë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e palës debitore, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të vulave protokollare të vendosura në pjesën e sipërme. Nga zbërthimi i aspekteve të tilla, rrjedh se dokumentet e lartëcekura i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara ligjore për të shërbyer si bazë për caktimin e përmbarimit, në kuptim të dispozitës nga neni 29, lidhur me nenin 21 të LPP-së. Po ashtu, propozimi për përmbarim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me dispozitën e nenit 38 par.1 të LPP-së.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorit përmes prapësimit, të cilat përqendrohen në disa aspekte:

Pretendimi i parë ka të bëjë me faktin se dokumentet e bashkangjitura në propozimin për përmbarrim – faturat me të dhënat e specifikuar nuk e kanë cilësinë e dokumenteve të besueshme, siç parashihet me dispozitën e nenit 29 të LPP-së. Përgjigjen në raport me këto pretendime, Gjykata e ka konsumuar në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktvendimi, ku edhe janë elaboruar tiparet e faturave mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi, me ç'rast është konstatuar se të tillat i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara për të shërbyer si dokumente të përshtatshme për përmbarrim.

Pretendimi tjetër, që në fakt ka karakter të propozimit, ka të bëjë me kërkesën që në kuptim të dispozitës nga neni 73 par.1 të LPP-së, Gjykata të caktojë seancë publike në këtë çështje përmbarrimore. Në raport me këtë pretendim, Gjykata iu referua dispozitës së lartëcekur, e cila përcakton që: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit...”* Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se nga vështrimi i përmbajtjes së propozimit për përmbarrim, gjegjësisht Urdhërit Përmbarrimor të goditur me prapësim, e veçanërisht dokumenteve mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi, Gjykata disponon me material të mjaftueshëm për të vendosur lidhur me pretendimet e parashtruara nga palët ndërgjyqëse përmes prapësimit, respektivisht përgjigjes në prapësim, pa caktuar fare seancë gjyqësore. Ndërmarrja e një veprimi të tillë procedural, në prezencën e këtyre rrethanave, nuk do t'i ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës në raport me validitetin e prapësimit.

Pretendimi tjetër i palës debitore ka të bëjë me faktin se për pagesën e qirasë është kompetente të vendosë Gjykata në procedurë kontestimore, e kurrsesi përmbarruesi privat në procedurë përmbarrimore, sikurse ka vepruar në rastin konkret, duke aluduar në faktin se i njejt i ka shkelur kompetencat ligjore me rastin e lejimit dhe caktimit të përmbarrimit në bazë të Kontratës së Qirasë nr.01-5023/10 të dt.31.12.2019 dhe Marrëveshjes për Pagesën e Borxhit të dt.13.02.2020, për faktin se kompetenca ekskluzive lidhur me një çështje të tillë i takon Gjykatës.

Lidhur me këto pretendime, Gjykata sjellë në vëmendje faktin se kërkesat monetare (në të holla), mund të realizohen edhe mbi bazën e prezantimit të dokumenteve të besueshme, të cilat janë të listuara në dispozitën e lartëcekur të nenit 29 të LPP-së, në mesin e të cilave dokumente bëjnë pjesë edhe faturat. Në anën tjetër, kompetenca e organit përmbarrues për të lejuar përmbarrimin mbi bazën e dokumenteve të tilla derivon nga dispozita e nenit 21 të LPP-së. Në rastin konkret, përmbarrimi nuk është caktuar mbi bazën e Kontratës së Qirasë nr.01-5023/10 të dt.31.12.2019 dhe Marrëveshjes për Pagesën e Borxhit të dt.13.02.2020, siç aludon pala debitore në prapësim, por mbi bazën e faturave me të dhënat e përshkruara në pjesën e mësipërme të arsyetimit. Për më tepër, edhe pala debitore në mesin e pretendimeve në prapësim u është referuar këtyre faturave, duke theksuar se nuk e kanë cilësinë e dokumenteve të besueshme konform nenit 29 të LPP-së, që nënkupton se e ka legjitimuar faktin se Urdhëri Përmbarrimor është lëshuar duke u bazuar pikërisht në këto fatura. Megjithatë, pala debitore nuk ka ndonjë pengesë që pretendimet lidhur me vlefshmërinë e kontratës, respektivisht marrëveshjes së lartëcekur të lidhur me palën kreditore, t'i adresojë përmes inicimit të procedurës kontestimore. Procedura përmbarrimore udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal, që nënkupton se fokusi përqendrohet vetëm tek vlerësimi i tiparave të dokumentit mbi bazën e të cilin është lejuar përmbarrimi.

Bazuar në këto konstatime, Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, erdhi në përfundim se nuk kanë ardhur në shprehje asnjëra nga shkaqet e prapësimit të parapara me dispozitën e nenit 71 të LPP-së, që do të mund të ndikonin në shfuqizimin e Urdhërit Përmbarimor të goditur në prapësim. Mbi këtë bazë, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar prapësimin e debitorit, si dhe duke e lënë në fuqi Urdhërin Përmbarimor P.nr.060/20, të dt.05.03.2020, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat K.M në Prishtinë.

Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi palën debitore që në rast të parashtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 90,000.00 €, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën III të dispozitivit e paralajmëroi të njëjtwn se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL-
PPP.nr.607/20, datë 25.04.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 77 të LPP-së është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.